



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.2409/2017

05 - 02 - 2018

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me sekretaren juridike Ardrita Imeri, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga [REDACTED], rruga [REDACTED], për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.632-7/2016 e dt.27.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorës së shtetit Bahri Hyseni, të akuzuarit [REDACTED], me dt.20.12.2017, solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga [REDACTED], [REDACTED], i lindur me [REDACTED], në fshatin [REDACTED], Komuna [REDACTED], nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollen e mesme, i martuar, baba i katër fëmive i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri, me numër personal [REDACTED],-

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

-se me dt.31.02.2016 rreth orës 08:20, në Ferizaj, saktësisht në lokalitetin [REDACTED], i pandehuri i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit [REDACTED], në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje për shkak të një parkingu në mes të dëmtuarit dhe bashkëshortes së të pandehurit, ku bashkëshortja e kishte thirr të pandehurin në telefon dh i pandehuri me të arritur e godet të dëmtuarin me grushte dhe shqelma në trup derisa ndërhyjnë vllau i të pandehurit dhe i ndan, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shndetit të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të datës 23.07.2017,-

-me çka ka kryer veprën penale "lëndim i lehtë trupor" nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

**G J Y K O N
 ME DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit [REDACTED], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjet / Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 60 ditësh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

I dëmtuari [REDACTED], nga [REDACTED] Komuna [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 €, këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.632-7/2016 e dt.27.09.2017, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], rruga [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 245 par.1 të KPPK-së, për datën 20.12.2017, në këtë çështje penale kishte caktuar shqyrtimi fillestar dhe ishin të pranishëm prokurori i shtetit Bahri Hyseni, i akuzuri [REDAKTUAR] kurës e i dëmtuar nuk ka prezetuar në shqyrtim fillesta e në ftesën për dërgim persona shpërndarsi i ftesave nga ana e postës ka thekësuar se i dëmtuari [REDAKTUAR] jeton jashtë vendit në shtetin e Anglis.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestara i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë rrspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR], ka deklaruar se e ndien vetën fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të aktakuzës, është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe pse i dëmtuari nuk është prezent në shqyrtimin fillestar i kërkon falje dhe është penduar për veprimet që i ka ndërmarur kundër tij, shka i kryerjes së kësaj vepre penale ka qenë se atë ditë në mëngjezë e ka thirrur bashkëshortja e tij se një person e kishte fyer në parkingun e shitores [REDAKTUAR] në Ferizaj, menjëher ka shkuar aty pasi ishte i marakosur dhe është përleshur me të dëmtuarin por në ndërkoh ka ndërhyr vlla i tij dhe i ka ndarë, ka premtuar se nuk do të prsërisë veprime të tilla do të jet më i kujdsshëm, ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shpalljes fajtor ti shqiptohet një snaksion penal më i butë pasi është mbajtës familjes.

Pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me povat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njejtin ta pranoj si të till.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në eksperizen mjeko ligjore e datës 23.07.2017 në deklaraten e të akuzuarit dhe të dëmtuarit dhënë në polici, si dhe shkresat tjera të cilat gjinden në lëndë.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale penale " lëndim i lehtë trupor "nga neni 188 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, pendimin e kryerjes së veprës penale, kërkim falje shprehur për të dëmtuarit edhe pse nuk ishte në shqyrtim fillestar, pendimin për veprën e kryer, ka thekësuar se është hera e parë që ballafaqohet me gjykatë, ka treguar sinqeritet në procedurën penale, ka premtuar se veprime të tilla nuk do të përsëris në të ardhmen është baba i katër fëmive, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoj dënimin me gjobë në shumë prej 150 / njëqind e pesëdhjetë/ Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 60 ditësh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.


Në bazë të nen. 450 par.2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së gjykata të akuzuarin e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 40 €.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.2409/2017 datë 20.12.2017

Sekretarja juridike
Ardrita Imeri

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.